POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 E nisi ters, Adea Pirdeni humbet fillin e fjalimit para Ramës, ja çfarë i tha kryeministri

2 Ndërron jetë në moshën 41-vjeçare regjisori Gjergj Mena! Humbi betejën me sëmundjen e rëndë

3 'Qetësohet' protesta, përfundon bojkoti i studentëve! Një grup i vogël shkon në disa universitete: Bojkotoni mësimin! Por refuzohen në auditorë

4 Ministri Malaj prezanton buxhetin 2027 te 'Ligjet': Mbështetje mujore për fëmijët deri në 5-vjeç dhe dyfishim i bonusit të pensionistëve! Tre prioritetet kryesore

5 Protestat e dhunshme, dështim i demokracisë apo krizë e kapitalizmit?

Kronikë

Tiranë/ Grabitet me armë zjarri banka te Komuna e Parisit, autori i maskuar kërcënoi arkëtaren, mori paratë dhe u largua me monopatinë (VIDEO)

Autori i dyshuar ka hyrë brenda bankës i maskuar, me fytyrën të mbuluar me shall, i ka vënë armën mbi kokë arkëtares, duke i marrë paratë që gjendeshin atje dhe është larguar me monopatinë. Në një reagim, banka thekson se nuk ka pasur persona të lënduar mes punonjësve apo klientëve.

Watch on

Redaksia
2 Nëntor, 10:49 | **Përditesimi: 2 Nëntor, 14:28**

Share Post

Një bankë e nivelit të dytë u grabit me armë paraditen e sotme në zonën e Komunës së Parisit në Tiranë. Ngjarja ndodhi rreth orës 10:45, kur brenda filialit kishte punonjës dhe klientë.

Autori, i maskuar, sapo hyri brenda bankës i drejtoi armën rojës që ishte brenda te dera, dhe bashkë me të, nën kërcënim, iu drejtua arkës.

Burimet bëjnë me dije se më pas i vuri armën kokë arkëtares, së cilës i kërkoi paratë. Pasi i mori, ai u largua me shpejtësi me një monopatinë, në drejtim të stadiumit "Selman Stërmasi".

LEXO EDHE:
Një grup protestuesish marshojnë drejt Kryeministrisë, kërkojnë dorëheqjen e Ramës (VIDEO)

> *"Rreth orës 10:45, në zonën e Komunës së Parisit, një shtetas i maskuar ka hyrë në ambientet e një banke të nivelit të dytë dhe, nën kërcënimin e një sendi në dukje armë, dyshohet se ka marrë një shumë parash. Menjëherë pas marrjes së njoftimit, janë ngritur pika kontrolli dhe janë orientuar të gjitha shërbimet policore, me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorit", njoftoi **Policia**.*

Ndërkohë, në një reagim banka thekson se nuk ka pasur persona të lënduar mes punonjësve apo klientëve.

> *"Theksojmë që nuk ka pasur persona të lënduar mes punonjësve apo klientëve tanë. Siguria dhe mirëqenia e punonjësve dhe klientëve tanë mbeten prioriteti ynë kryesor. Banka po bashkëpunon plotësisht me autoritetet përkatëse për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes. Duke qenë se procesi hetimor është në vijim, në këtë fazë nuk mund të ndajmë informacion të mëtejshëm, në respekt të punës së autoriteteve kompetente", thuhet në reagimin e bankës.*

Policia mbërriti në vendin e ngjarjes, ndërsa po punon për identifikimin dhe lokalizimin e tij. Deri tani mbetet e paqartë shuma e grabitur, ndërsa po bëhet inventarizimi nga punonjësit e bankës.

R.Xh / SI.E. | A.Hl | Shqiptarja.com

TAG: policia Tirane grabitje me arme grabitje bankat

Sa e vlerësoni këtë artikull? 1.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Erik: 02/11/2026 10:53
Eshte i kapur, s'ka ku fshihet, ndonje budall i rradhes.
Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 29 Tetor, 18:29
A besoni se TVSH-ja 6 përqind për ushqimet do të reflektohet si duhet në uljen e çmimeve?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Drogë në pije të rinjve për 'halloween'? QSUT hedh poshtë pretendimet: Është lajm i rremë, kemi pasur raste vetëm abuzimi me alkoolin (VIDEO)
2 Nëntor, 13:57

SMS mashtruese në emër të bankave! Policia paralajmëron qytetarët: Mos klikoni në linke, rrezikoni paratë në llogari
2 Nëntor, 13:18

Filmi i animuar shqiptar 'Zemërimi i shkronjave' do të restaurohet pas 45 vitesh, Autorja: Fëmijët ta ruajnë gjuhën shqipe si sytë e ballit (VIDEO)
2 Nëntor, 12:56

'Qetësohet' protesta, përfundon bojkoti i studentëve! Një grup i vogël shkon në disa universitete: Bojkotoni mësimin! Por refuzohen në auditorë
2 Nëntor, 11:04

Dyshohet se ra nga shkallët, Saimir Vishaj në gjendje të rëndë shëndetësore! Avokati i intubuar te Trauma
2 Nëntor, 10:37

Pas akteve të dhunshme dje, një grup protestuesish grumbullohen te kryeministria! Asnjë incident, shpërndahen protestuesit (VIDEO)
1 Nëntor, 17:52

Po transportonin 4 emigrantë të paligjshëm kundrejt parave, arrestohen në Gjirokastër 2 të rinj nga Bulqiza! S'ju bindën urdhrit të Policisë për të ndaluar (VIDEO)
1 Nëntor, 12:45

Dhuna në protestën e djeshme në Tiranë, momenti kur Policia gjen molotovët brenda makinës së 2 personave të maskuar (VIDEO)
1 Nëntor, 11:27

I dyshuar për disa vjedhje në Tiranë dhe Vlorë, arrestohet në kryeqytet 34-vjeçari (EMRI)
Sokol Dema
1 Nëntor, 11:17

Protestat në Tiranë/ Avokati i Popullit: Intervistimi i të miturve s'regjistrohet
1 Nëntor, 11:08

Vodhën 4 markete e lokale gjatë 1 jave në Durrës, arrestohet 31-vjeçari, në kërkim bashkëpunëtori i tij (VIDEO)
1 Nëntor, 10:36

Shpërthim me tritol në një dyqan lulesh në Tufinë, identifikohet autori
1 Nëntor, 10:07

Lajmi i fundit

Spahiu: Arlind Qori ka meritë historike që largoi Berishën dhe PD nga rrëmbimi i protestës
2 Nëntor, 15:03

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

× [sh].com Lajmi i fundit

Spahiu: Arlind Qori ka meritë historike që largoi Berisheën dhe PD nga rrëmbimi i protestës

2 Nëntor, 15:03